



Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, në bazë të neneve 23 dhe 24 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, nenit 10 pika 1 dhe 2 e Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për transparencë në komuna dhe nenit 7 të Rregullores Komunale për Transparencë NR.03/2019, Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Zyrën për Informim, bën:

NJOFTIMIN

PËR

TAKIMIN E DYTË PUBLIK TË KRYETARIT

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara, se Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi organizon takimin e dytë publik me qytetarë për punën e tij gjatë vitit 2022.

Takimi publik me qytetarë do të mbahet më datë: **20.12.2022 (e martë), në orën 11:00**, në sallën e Kuvendit Komunal në Rahovec. Në këtë takim do të keni mundësi të njiheni për punën e qeverisë komunale për vitin 2022 dhe zhvillimet aktuale në Komunë.

Po ashtu qytetarët pjesëmarrës në takim mund t'i bëjnë pyetje dhe komente ekzekutivit të Komunës për të gjitha temat të cilat atyre ju interesojnë.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri më datë: **20.12.2022** në ora **11:00**, në e-mailat: ali.morina@rks-gov.net dhe blerta.gashi@rks-gov.net.

Jeni të mirëpritur!

